



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 80 datë 23.05.2025



MIRATIMIN E STRATEGJISË SË PLANIT TË VEPRIMIT TË TURIZMIT
2025-2030, BASHKIA PËRMET.

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji Nr. 93/2015 "Për Turizmin" i ndryshuar, VKM Nr. 711/dt. 12.10.2016 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret për projektimin e strukturave akomoduese", Vendimi Nr. 22/dt. 12.01.2018 "Për miratimin e kriterëve për Çertifikimin e veprimtarisë së agroturizmit", VKM nr. 466, datë 31.07.2025, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030 dhe planit të veprimit "dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratohet Strategjia e Planit të Veprimit të turizmit 2025-2030, Bashkia Permet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Bujqësisë dhe Turizmit, Drejtoria e Financës, burimeve njerëzore dhe shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Projekteve dhe Integritimit Evropian si dhe të gjitha drejtorit dhe sektorët që janë pjesë e këtij plani startegjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).


Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

STRATEGJIA E PLANIT TË VEPRIMIT TË TURIZMIT 2025-2030

BASHKIA PËRMET





I. Hyrje: Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Bashkisë

Përmeti është një nga ato vende ku natyra, historia dhe kultura gërshetohen në mënyrë të mrekullueshme. Qyteti ynë, i njohur si “Perla e Jugut”, është i rrethuar nga male madhështore dhe i lagur nga ujërat e kristalta të Vjosës, lumit të shpallur tashmë Park Kombëtar. Brenda pak kilometrash, vizitorët mund të shijojnë burimet termale të Bënjës, të ecin në gjurmët e historisë tek kisha e Shën Mërisë në Leusë, të sodisin peizazhin e Grykës së Këlcyrës apo të zbulojnë biodiversitetin e Parkut të Bredhit të Hotovës.

Por Përmeti nuk është vetëm natyrë. Është gjithashtu kulturë dhe traditë. Është vendlindja e vëllezërve Frashëri, e klarinetës e polifonisë dhe e sazeve që mbajnë gjallë shpirtin e kësaj treve. Është qyteti i trëndafilave dhe i mikpritjes së rrallë, ku çdo mysafir pritët si mik i shtëpisë. Vizitorët që vijnë, largohen me kujtime të ngrohta dhe me shijen e reçelërave, glikove e gatimeve tradicionale që nuk i gjen askund tjetër.

Vitet e fundit, Përmeti ka fituar një profil të ri turistik. Ekoturizmi, turizmi i aventurës me rafting dhe kajak në Vjosë, shëtitjet malore, si dhe agroturizmi, kanë bërë që numri i vizitorëve vendas dhe të huaj të rritet ndjeshëm. Gjithashtu ne synojmë për një turizëm të shtrirë në të gjithë vitin dhe duke ofruar guida turistike dhe qëndrim sa më të gjatë. Gjithashtu sot, qyteti ynë vizitohet nga turistë europianë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe nga vende të tjera të rajonit, duke u bërë pjesë e itinerareve më të rëndësishme të udhëtimeve në Shqipëri.

Strategjia e Turizmit 2025–2030 është një udhërrëfyes i qartë për të ardhmen. Ajo synon të ruajë vlerat unike të Përmetit dhe njëkohësisht t’i japë turizmit rolin që meriton në zhvillimin ekonomik e shoqëror të qytetit dhe fshatrave tona. Ky plan do të ndihmojë që turizmi të mos mbetet vetëm një mundësi, por të kthehet në një motor të fuqishëm për punësim, përmirësim të cilësisë së jetës.

Jam e bindur se me këtë strategji dhe me bashkëpunimin e të gjithëve, institucioneve, bizneseve dhe komunitetit, Përmeti do të vazhdojë të rritet si një destinacion turistik cilësorë dhe i qëndrueshëm.

Tabela e Përmbajtjes

II. Grupet e punës dhe Kuadri ligjor

III. Metodologjia

- 3.1- Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues
- 3.2 - *Drejt një strategjie për turizmin Përmet*
- 3.3 - *Plani strategjik për zhvillimin social dhe ekonomik 2020-2030.*
- 3.4 - *Përgatitja e draft dokumentit të SPVT 2025 – 2030*
- 3.5- *Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit*
- 3.6- *Finalizimi i draft SPVT 2025-2030 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara*
- 3.7- *Miratimi i SPVT 2025 – 2030 në Këshillin Bashkiak*



IV. Një prezantim i Bashkisë Përmet

- 4.1 Gjeografi
- 4.2 Kulturë
- 4.3 Popullsia dhe treguesit demografikë
- 4.4 Arsimi
- 4.5 Shëndetësia
- 4.6 Ekonomia
- 4.7 Punësimi dhe papunësia

V. Drejt një strategjie për turizmin

- 5.1 Vizioni për turizmin shqiptar (2025-2030)
- 5.2 -Qëllimet strategjike kombëtare
- 5.3- Plani strategjik i Përmetit për zhvillimin social dhe ekonomik 2025-2030
- 5.4- Pushteti lokal dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me turizmin
- 5.5 -Mbështetja për zhvillimin e turizmit
- 5.6- Planifikimi për turizmin
- 6.7-Turizmi në Përmet
- 6.8-Vendi i origjinës,mosha
- 6.9-Tregui i brendshëm

VI. Konkurrenca

VII. . Strategjia e turizmit për Përmetin

VIII. Misioni ,Vizioni dhe Objektivat strategjike

IX. . Plani i veprimet per turizmin

X. Buxhet i përgjithshëm

XI Monitorim dhe vlerësim



Grupi qëndror i punës:

• Aulona	Meshini	N/kryetar i Bashkisë
• Etleva	Myftari	Drejtor i Zhv. Ekonomik dhe Turizmit
• Etleva	Kreci	Drejtor financë,burime njerëzore
• Klaudja	Ciko	Drejtor i projekteve dhe integ. Evropian
• Arjana	Papapano	Drejtor i Mbësh. Sociale,arsim,kulturë,spor
• Laert	Bushi	Drejtor i Urbanistikës
• Kristiana	Theodhori	Specialist i turizmit
• Vangjela	Naqe	Përgj. E Financës
• Ledjan	Komino	Specialist kulture
• Jorgji	Çurro	Kryetar i Shoqatës” FLOEM”
• Kristjana	Ibrahimi	Administratore qyteti
• Julian	Elezi	Anëtar i GVV pro Përmet
• Enea	Kushe	Përgj. i zyrës juridike
• Ylli	Dervishi	Adm. Njësia Ad. Petran

2- Grupet e punës për:

➤ **Vizionin dhe përparësitë**

• Aulona	Meshini	N/kryetar i Bashkisë
• Etleva	Myftari	Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
• Klaudja	Ciko	Drejtor i Projekteve dhe Integrimit Evropian
• Sokrat	Kondili	Anëtare e Këshillit Bashkiak
• Anxhela	Dauti	Drejtor kabineti
• Loreta	Mamani	Eksperte

➤ **Analizën e gjendjes dhe buxhetin e përafërt**

• Etleve	Kreci	Drejtor financë,burime njerëzore
• Klaudja	Ciko	Drejtor i projekteve dhe integrimit evropian
• Etleva	Myftari	Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

➤ Vëzhgim dhe monitorim të zbatimit të SPVT 2025-2030:

• Etleva	Myftari	Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
• Klaudja	Ciko	Drejtor i Projekteve dhe Integritimit Evropian
• Arjana	Papapano	Drejtor i Mbësh. Sociale, arsim, kulturë, sport
• Vangjela	Naqe	Përgj. i Buxhet, Financë
• Anxhela	Dauti	Drejtor Kabineti
• Kristjana	Ibrahimi	Adm. qyteti
• Kristiana	Theodhori	Spec. turizmi

Kuadri ligjor

Lgji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar;

Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ligji Nr.93/20215 “ Për Turizmin” i ndryshuar;

VKM Nr.711.dt.12.10.2016 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret për projektimin e strukturave akomoduese”

Vendimi Nr.22.dt.12.01.2018 “Për miratimin e kriterëve për Çertifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”

Nr.466, datë 31.7.2025 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030 dhe të planit të veprimit



III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e SPVT 2025-2030 ishte gjithëpërfshirëse dhe me mbështetjen e shoqatës “FLOEM” me ekspertin Loreta Mamani, plani u zhvillua përmes hapave në vijim:

3.1- Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues. Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentash ekzistues apo draft dokumentash të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me turizmin.

3.2- Drejt një strategjie për turizmin Përmet

Analiza e tregjeve ekzistuese të turizmit dhe atyre me mundësi zhvillimi në Përmet, pasuritë, nevojat dhe qëllimet strategjike.

3.3- Plan i strategjik për zhvillimin social dhe ekonomik 2020-2030. Identifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit si një objektiv me përparësi për rritjen e ekonomisë lokale, Zhvillimi i turizmit në harmoni me vlerat kulturore-historike, etnografike dhe natyrore të qytetit.



3.4- Përgatitja e draft dokumentit të SPVT 2025 – 2030. Drafti i përgatitur për konsultim përmbante seksionet dhe të dhënat kryesore, vizionin, drejt një strategjie të turizmit në Përmet, objektivat specifike, masat dhe veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifike. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

3.5- Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit. Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, OSHC-të. Në dy konsultime kryesore të zhvilluara përkatësisht, një konsultim më datën 12.08.2025 dhe një konsultim më datën 25.08.2025 u përfshinë rreth 100 pjesëmarrëse e pjesëmarrës.

Po kështu, qëndroi i hapur për publikun për të mbledhur rekomandimet deri në dt.05.09.2025. Gjithashtu u mbledhën sygjerrimet nga komuniteti dhe grupet e interesit nëpërmjet një pyetësor online. SPVT u postua për konsultim publik edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, i aksesueshëm në:

3.6- Finalizimi i draft SPVT 2025-2030 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara. Finalizimi i draft SPVT u bë në bazë të komenteve dhe sugjerimeve të marra gjatë konsultimit të tij. Paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakordësuara.

3.7- Miratimi i SPVT 2025 – 2030 në Këshillin Bashkiak. Versioni përfundimtar i SPVT i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, SPVT 2025 – 2030 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë. Strategjia e Planit të Veprimeve të Turizmit 2025-2030 i Bashkisë Përmet, u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.

IV.NJË PREZANTIM I BASHKISË PËRMET

4.1-Gjeografia

Përmeti bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë. Kufijtë gjeografikë janë: Greqi dhe Gjirokastra në jug; Skrapari dhe Berati në veri; Kolonja në lindje dhe Tepelena në perëndim.

Ai bën pjesë në zonat malore dhe kodrinore me reliev tepër të thyer dhe të shumëllojshëm. Territori i rrethit ka shtrirje të madhe në drejtim vertikal, nga 160 metra deri 2485 metra (maja e Papingut në Nëmërckë). 6.3% e territorit shtrihet deri në lartësinë 300 m, 65.3 % mbi lartësinë 300m dhe 28.4% mbi 900 m mbi nivelin e detit.

Territori i Bashkisë ka burime të shumta natyrore, të cilat përbëjnë bazën e kontekstit ekonomik të bashkisë. Ndër to, përmendim burimet e shumta ujore. Lumi i Vjosës, një ndër lumenjtë kryesore të vendit tonë, përshkon territorin e bashkisë, duke përbërë aksin kryesor të organizimit dhe komunikimit të komuniteteve lokale në rrethin e Përmetit të cilat kanë një identitet të fortë territorial, për shkak të vendodhjes në luginën e Vjosës. Burimet termale të Bënjës, ujrato e së cilës kanë veti kurative për një sërë sëmundjesh, përbëjnë një nga pasuritë më të njohura të burimeve nëntokësore të zonës. Territori i bashkisë është vendi ku shtrihet edhe masivi pyjor Parku kombëtar «Bredhi i Hotovës». Biodiversiteti i këtij parku është i lartë. Vlerat natyrore, peizazhit dhe ato historike e kulturore ofrojnë potenciale të mëdha për zhvillimin e ekoturizmit. Zhvillimi ekonomik, nëpërmjet ekoturizmit dhe formave të tjera si sportet ujore etj., lidhen ngushtësisht me menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Për shkak të pozicionit gjeografik jugor në Përmet takohet klima mesdhetare kodrinore, mesdhetare paramalore dhe mesdhetare malore. Ndërkohë relievi kryesisht kodrinoro malor kushtëzon ndryshime të dukshme në drejtim vertikal deri në shfaqjen e klimës malore. Sasia mesatare e rreshjeve varion nga 1149 mm në 1355mm. Temperatura mesatare më e lartë është 34⁰C dhe më e ulët është -2⁰C.

Qyteti që këmbët i lag në ujrat e Vjosës i shpallur Parkë Kombëtar dhe kryet i mbështet në shpinën e malit të Dhëmbelit, shtrihet në një sipërfaqe të vogël që së bashku me rrethinat shkon deri në 601.95km²kilometra katrorë. Në antikitet kjo zonë njihej me emrin Trifilia, pjesë e "Rajonit Melotid". Sipas legjendës qyteti ka marrë këtë emër nga heroi i kohëve të lashta i quajtur Premt i cili për të mos rënë i gjallë në duart e armiqve u hodh nga "Guri i Qytetit", një shkëmb në afërsi të qendrës së qytetit.

I gjelbëruar si asnjë qytet tjetër, me një "strukturë urbane", "të patjetërsuar" qysh nga viti '64, por e projektuar 200 vjet më parë nga inxhinieri kalabrez që njihet si Mulla Sulejmani, është unik për vlerat e tij. Qyteti u krijua si një qendër administrative, në shekullin e XV dhe XVI, cituar nga të dhëna historike turke, si një lokalitet i pasur me tregje, dyqane magazina dhe bujtina, kështu kjo zonë ishte një qendër e lulëzuar komerciale. Të dhëna historike otomane të viteve 1431-1432 referojnë se qyteti kishte 42 shtëpi ndërkohë në shekullin XVI numëronte 136 shtëpi. Në vitin 1938 Përmeti kishte rreth 3000 banorë dhe 104 fshatra si zona të ndara. Gjatë Luftës së Dytë Botërore është djegur e përmbytur katër herë duke e shndërruar kështu disa herë. Qyteti numëron sot rreth 10614banorë.

4.2-Kulturë

Përmeti dallohet për një traditë të gjatë letrare dhe muzikore. Përmeti është vendlindja e tre vëllezërve Sami, Abdyl dhe Naim Frashëri dhe disa personaliteteve të njohura të kulturës mbarë shqiptare siç është skulptori Odhise Paskali, shkrimtari Nonda Bulka, artistja e popullit Tefta Tashko Koço, etj..

Muzikantë të dalluar të nivelit kombëtarë si Mentor Xhemali e Laver Bariu, fama e të cilëve i ka kapërcyer kufijtë e trojeve shqiptare, janë përkujdesur që muzika përmetare të dallohet me karakteristikat e saj të një tradite të gjatë kulturore.

Jemi në vendin ku klarineta, siç quhej në vendet e origjinës, në këtë trevë falë këtyre sazeve, mori një emër të dytë gërmëtë. Kënga folklorike në rrethin e Përmetit këndohet në fshat dhe në qytet. Kënga në fshat këndohej në mënyrë polifonike toske, ndërsa kënga qytetare ka si karakteristikë të vetën shoqërimin me orkestrinë popullore të këngëve që këndohen edhe në këtë rast sipas mënyrës polifonike toske.

Kënga popullore përmetare karakterizohet në përgjithësi nga plani lirik i botës së brendshme shpirtërore.Lirizmi i hollë, i butë , i ndjeshëm, tërheqës i ëmbël e melodioz, përbën tiparin kryesor të këngës popullore përmetare.

Një tjetër traditë e këtij qyteti janë shumëllojshmëria e trëndafilave që gjenden në të gjithë qytetin,në park si dhe në shtëpitë e vjetra nga ku ka marrë dhe emrin "Qyteti i trëndafilave". Përmeti, është një mundësi më shumë për turistët që të mund të shijojnë dhe përjetojnë bukuritë e tij, si në turizëm kulturor,historic, shëndetësor dhe atë ekologjik. Një udhëtim i thjeshtë në Përmetin jugor,



aty ku banorët jetën e krahasojnë me “dimrin e përjetshëm”, me ujrat termale dhe banesat popullore, me profetet e shqipes, vëllezërit Frashëri, me grykën e Këlcyrës dhe peizazhe origjinale që për çdo kalimtar lë mbresa të rralla.

Përmeti mund të quhet pa frikë “Perla e Jugut”, pasi edhe të udhëtosh drejt tij, sot është mjaft komode. “Guri i Qytetit”, është kthyer në një pikë referimi për qytetin ku mund të sodisësh rrugët, ndërtesat, shtëpitë karakteristike, kishat, xhamitë, teqe, deri te saksitë e luleve në parvazet e dritareve. Një nga resurset natyrore më të çmueshme janë burimet termale të Bënjës, fshat i ndodhur rreth 14 km nga Përmeti.

Burimet e ujrave termale janë natyrore dhe të mbledhura në gjashtë vaska të vogla, që formojnë liqene natyrale me një bukuri të vyer. Cdo vaskë, është e përdorshme për trajtimin e një problemi specifik, në bazë të cilësive kurative të burimit që rrjedh: reumatizëm, sëmundje dermatologjike, akne, ostoporozë, gastrit etj.


Përmeti është vendi ideal për pushime dhe aventura familjare, pasi kombinon ecjen në kanion, lundrimin e lumit me gomone apo kajak. Një panoramë e mrekullueshme ku gërshetohen me njëra-tjetrën, janë kanionet e Lengaricës, me bukuritë e tyre, lumi i Lengaricës, Ura e Kadiut prej guri me një hark të madh, e ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës, Ura e Dashit etj.. Disa vlera të veçanta në këtë qytet turistik, janë ikonostaset e mrekullueshme të kishës së Leusës, ku mjeshtëria e artit të gdhendjes së drurit ka kaluar në përsosmëri, krahas afreskeve me ikona shenjtorësh, plot ngjyra art të vërtetë dhe mister. Ndërkohë që ia vlen të shihet edhe kisha e shekullit të XII të Shën Mërisë. Në qytet ndodhen edhe 15 kisha të tjera dhe 1 xhami.

Përmeti është i njohur në mbarë Shqipërinë për mikpritjen dhe gatimet e shkëlqyera.

Tradita e gatimeve të njohura përmetare, si kundër prodhimit të reçelërave dhe glikove, e bëjnë edhe më atraktivë këtë qytet për turistët vendas e të huaj. Në këtë qytet gjen gatime tradicionale, me prodhime bio të këtyre anëve, si shqeto e dollma me gjethe pjergulle, pulë me arra dhe roshnica, raki e rrushit të lisave dhe një shumëllojshmëri verërash të kuqe e të bardhë përmetare.

Fjalë të mira për Përmetin dhe përmetarët kanë shprehur edhe personalitete të shquar si; Fan Noli dhe Faik Konica. Ndërsa Edit Durhami do të shkruante në ato kohe se, “Përmeti, me qiparisat e lashtë, dushqet e purpurtë, gjelbërimin pranveror dhe njerëzit e mbrekullueshëm, m’u duk një nga vendet më të bukura të botës”. Bukurinë e shpirtit dhe mikpritjen e rrallë të përmetarit e gjen edhe në sentencën sa proverbiale, aq dhe popullore: “Kush shkoi mik në Përmet, dhe s’e pritën porsi mbret”.

HARTA E SHQIPËRISË, SHËNUAR BASHKIA PËRMET



Vlerat e pasura të trashëgimisë historike, kulturore, etnografike, arkitekturore dhe natyrore të qytetit përbëjnë një bazë të fuqishme për zhvillimin e turizmit. Si rrjedhim, zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit i ka të gjitha mundësitë të ndihmojë zhvillimin ekonomik, shoqëror, dhe mjedisor të rajonit. Përmeti tanimë po tërheq një numër përherë e më të madh vizitorësh si nga Shqipëria ashtu dhe nga jashtë, veçanërisht që nga përfshirja e lumit Vjosë në Park Kombëtar. Zhvillimi i ndjeshëm i turizmit shihet si objektiv me përparësi në Planin Strategjik të Përmetit për Zhvillimin Social dhe Ekonomik. Përmeti është akoma në hapat e para të formimit të një profili kombëtar dhe ndërkombëtar si një destinacion cilësor, kulturor dhe historik. Për këtë kërkohen përpjekje të koordinuara në ruajtjen dhe shpalosjen e vlerave të tij historike dhe kulturore, duke zvogëluar rreziqet e ndryshme si ndërtimet pa leje në lagjen historike, duke përmirësuar shërbimet për vizitorët, duke rritur shumëllojshmërinë e produkteve dhe të ndërhyrjeve të planifikuara në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit që do të sjellë përfitime për komunitetin vendas.



Strategjia për Turizmin dhe Plani i Veprimit për Përmetin (STPV) është një plan i detajuar i angazhimit të Bashkisë së Përmetit për zhvillimin e turizmit në pesë vitet e ardhshme. Plani është një dokument zyrtarisht i miratuar, i hartuar nga *Komiteti i Veprimit për Turizmin (KVT)* që përfshin përfaqësues të qeverisjes lokale, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Plani shpreh qartë vizionin e Përmetit për t'u shndërruar në një destinacion cilësor të zhvilluar mbi parimet e qëndrueshmërisë. Ai identifikon veprimet në katër fusha kyçe strategjike: a) Krijimi dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve. b) Mundësitë e shfrytëzimit dhe infrastruktura. c) Marketimi dhe promovimi. d) Burimet njerëzore dhe menaxhimi i destinacioneve. Plani mbështetet në një proces bashkëpjesëmarrës duke përfshirë analizat e tregjeve ekzistuese dhe atyre të mundshme për turizëm në këtë zonë, pasuritë dhe nevojat, marrëveshjet mbi qëllimet dhe objektivat strategjike dhe identifikimin e programit të aktiviteteve për t'i realizuar ato. Përfshirja e komunitetit të Përmetit në zhvillimin e planit ka çuar në krijimin e pronësisë lokale. Rezultati i kësaj është një dokument pune i cili është përdorur për të nxitur dhe për të drejtuar veprimet. KVT-ja ka përgjegjësinë e mbikqyrjes së zbatimit të planit, më tepër se sa të mbështetjes tek ekspertët e jashtëm.

Bashkia Përmet bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit. Ajo kufizohet në veri me Skraparin, në lindje me Bashkinë Kolonjë, në perëndim me Bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë dhe në jug me Konicën, Greqi. Qendra e Bashkisë është qyteti i Përmetit, i cili përfaqëson qendrën e zhvillimit ekonomik dhe social jo vetëm për Bashkinë e Përmetit por të gjithë komunitetit gjeografik që njihet si Lugina e Vjosës.

Bashkia e Përmetit përbëhet nga 5 (pesë) njësi administrative të cilat janë: Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Të gjitha njësitë e bashkisë janë njësi malore duke qenë se terreni është i pjerrët në më shumë se 45% të sipërfaqes së tij.

Tabela 1 - Përbërja administrative e territoriale e bashkisë Përmet.

Bashkia	Njësitë administrative	Qytetet dhe fshatrat respektive
Përmet	Përmet	Qyteti Përmet
	Çarshovë	Fshatrat; Çarshovë, Vllaho, Psillotere, Biovizhde, Zhepë, Draçovë, Iliar, Munushtir, Strëmbec, Pëllumbar, Kanikol
	Frashër	Fshatrat; Frashër, Zavalan, Ogren, Kostrec, Gostivisht, Miçan, Verçisht, Kreshovë, Soropull
	Petran	Fshatrat; Petran, Leshnicë, Leus, Lipe, Qilarishtë, Badilonjë, Bënje, Novosele, Delvinë, Kaludh, Lupckë, Gjinakar, Ogdunan, Lipivan-Trabozishtë, Tremisht, Bodar
	Qendër Piskovë	Fshatrat; Piskove, Bual, Kosine, Rapcke, Mokricë-Zleushë, Kutal, Kosovë, Hotovë, Odriçan, Raban, Alipostivan, Borockë, Gosnisht, Pagri, Pacomit, Grabovë, Argovë

Territori i Bashkisë është i organizuar përgjatë luginës së lumit Vjosa. Njësitë e Çarshovës, Petranit, Përmetit dhe një pjesë e Qendër Piskovë shtrihen përgjatë luginës, ndërsa, njësia administrative e Frashërit përbën skajin më të largët të bashkisë dhe është terësisht një zonë malore. Jetesa përgjatë luginës përcakton edhe një standart më të mirë jetese për komunitetet lokale krahasuar me ato që jetojnë më larg luginës.

4.3- Popullsia dhe treguesit demografikë

Përmeti bën pjesë në rajonin statistikor NUTS 3– Qarku Gjirokastrë. Tabela më poshtë jep informacion në lidhje me sipërfaqen, ndarjen administrative, dhe numrin e popullsisë.

Tabela 2 - Të dhëna mbi sipërfaqen, ndarjen administrative dhe numrin e popullsisë

Sipërfaqe (km ²)	Numri i Njësive Administrative	Numri i Qyteteve	Numri i Fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrimit Civil 2011	Popullsia sipas Census 2023
601.95	5	1	49	6,868	19,872	10,614

Burimi: Bashkia Përmet


Siç u përmend më lart, një pjesë e rëndësishme e territorit të bashkisë shtrihet në terren malor. Një reliev i tillë kushtëzon dendësinë relativisht të ulët të popullsisë për zonat më të largëta.

Popullsia e Bashkisë sipas Regjistrimit Civil 2023 raportohet 19.872 banorë. Më shumë se gjysma e popullsisë, rreth 56%, jeton në qytetin e Përmetit. Njësia administrative me numrin më të vogël të popullsisë është Frashëri. Njësitë e tjera (Çarshovë, Petran dhe Qendër Piskovë) përbëjnë 40% të popullsisë së bashkisë. Bashkia e Përmetit ka fshatra që kanë një numër shumë të ulët banorësh, siç është fshati Frashër i cili ka 683 banorë. Kjo analizë demografike na shërben për të orjentuar disa shërbime të kujdesit social të cilat diktohen nga situata të veçanta demografike siç janë shërbimet sociale dhe shëndetsore për të moshuarit e vetmuar në zona shumë larg qytetit ose malore.

Tabela 3 - Të dhëna për numrin e popullsisë sipas njësive administrative

Njësitë administrative	Censusi 2011			Regjistri civil 2023		
	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj	Total
Përmet	5.028	4.832	9.860	2.984	2.961	5945
Çarshovë	1.425	1.544	2.969	463	455	918
Petran	1.550	1.540	3.090	791	831	1622
Qëndër Piskovë	1.602	1.668	3.270	845	897	1742
Frashër	314	369	683	477	210	387
Total	9.919	9.953	19.872	5.260	4.904	10.614

Burimi: Bashkia Përmet





Në tabelën e mësipërme, shihet se raporti gjinor i popullsisë në Bashkinë Përmet është i balancuar. Gratë përfaqësojnë 50% të popullsisë totale. Popullsia e grupmoshës 15-64 vjeç që përfaqëson popullsinë aktive, përbën 66% të popullsisë. Ajo që vihet re në piramidën e moshës për Bashkinë Përmet është se grupmosha 65+ vjeç, përfaqëson 18% të popullsisë, tregues ky që është më i lartë se mesatarja e vendit (11.3%). Nga ana tjetër grupmosha 0-14 vjeç përbën 16% të popullsisë së Bashkisë Përmet, tregues i ulët në krahasim me mesataren e vendit (20.7%).

Tabela 4 - Popullsia, raporti sipas grupmoshave

Popullsia sipas grupmoshave	Bashkia Përmet	Mesatarja e vendit
	%	%
0-14	16%	20.7%
15-64	66%	68%
65- e lart	18%	11.3%

Burimi: Bashkia Përmet

I gjithë territori i Bashkisë është karakterizuar nga migrimi dhe emigrimi i popullatës në dy dekadat e fundit. Të dhënat e Census 2001 dhe 2011, tregojnë se popullsia e Bashkisë Përmetit është zvogëluar me më shumë se gjysmën e popullsisë (56%). Njësia administrative Frashër në harkun kohor 2001-2011, ka patur një largim masiv të banorëve në masën 82%. Po kështu, edhe popullsia e njësive administrative Çarshovë është ulur me 71%. Përmeti (qyteti) ka përqindjen më të vogël të popullsisë së larguar (51%), krahasuar me njësitë e tjera administrative.


Të dhënat tregojnë për një rënie të konsiderueshme të popullsisë për të gjitha njësitë administrative, e cila ka si shkak kryesor migrimin e brendshëm (largimin e banorëve drejt qytetit të Përmetit dhe qyteteve të tjera) dhe emigrimin (kryesisht në Greqi). Por ulja e popullsisë është shkaktuar edhe për shkaqe të tjera. Kështu, treguesit e lindshmërisë dhe vdekshmërisë të cilët përbëjnë variablat bazë për vlerësimin e shtesës natyrore të popullsisë tregojnë se ky tregues i shprehur si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve është negativ. Tabela më poshtë paraqet numrin e lindjeve, vdekjeve, martesave, dhe divorceve në periudhat 2017-2018 dhe 2021-2024. Numri i lindjeve është shumë i ulët. Në vitin 2022 për shembull janë regjistruar vetëm 17 lindje dhe deri në gjysmën e vitit 2024, numri i lindjeve në Përmet ishte 5.

Tabela 5 - Numri i lindjeve dhe vdekjeve për dy vitet e fundit në Bashkinë Përmet

Viti	2017	2018	2021	2022	2023	2024
Lindje	39	49	14	17	5	14
Vdekje	117	112	180	145	48	104
Martesa	15	27	42	35	21	28
Divorce	5	7	12	22	3	8

Burimi: Bashkia Përmet Zyra e Gjendjes Civile

**Shënim: Të dhënat e vitit 2023 janë të kufizuara deri në datën 30 qershor.*



Shtesa natyrore negative, migrimi dhe emigrimi kryesisht i popullatës aktive, kanë qenë faktorë të rëndësishëm të cilët kanë përcaktuar edhe tendencën e plakjes së popullsisë me ritme të shpejta. Procesi i plakjes vihet re nga rritja e lehtë e popullsisë mbi 65 vjeç, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re 0-14 vjeç.



4.4- Arsimi

Zona e Përmetit është një zonë e njohur për traditat e saj arsimdashëse. Vihet re një nivel i ulët i braktisjes së shkollës 9-vjeçare, si dhe interes i lartë për vazhdimin e shkollës së mesme dhe studimeve universitare nga ana e të rinjve. Kushtet e shkollave janë relativisht të mira me një numër mesatar prej 25 nxënësish në klasë. Për shkak të migrimit dhe emigimit, numri i shkollave 9-vjeçare ka rënë me 20%. Në total, Përmeti numëron 14 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme.

Tabela 6 - Të dhëna për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm

Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
Numri i shkollave 9-vjeçare	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
14	538	79	1	211	20

Burimi: Bashkia Përmet

Arsimi parashkollor. Vetëm qyteti i Përmetit ka një çerdhe dhe 2 kopshte me ushqim, ka edhe 8 kopshte pa ushqim (2 në qytet dhe 6 në fshatra).

Tabela 7 - Të dhëna për arsimin parashkollor

Çerdhet			Kopshtet		
Numri i çerdheve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve
1	25	6	8	139	19

Burimi: Bashkia Përmet

4.5- Shëndetësia

Një rëndësi të veçantë në shërbimin shëndetësor në Bashkinë Përmet ka shërbimi parësor, ky shërbim ofrohet nëpërmjet qendrave shëndetësore, ambulancave dhe poliklinikave. Në Përmet ka një spital qendror, një ambulancë, 8 qendra shëndetësore, dhe një poliklinikë. Shërbimet spitalore trajtohen në spitalin rajonal të Gjirokastrës pasi në Përmet nuk ka mjekë të specializuar.

Problematiche në spitalin Përmet mbetet mungesa e mjekëve të specializuar, gjë që sjell padyshim edhe vonesa në shërbime për moshën e tretë, por jo vetëm. Pajisja me aparatura dhe me mjekë do bënte të mundur që këto shërbime të jepeshin në kohë reale dhe nuk do përcilleshin në Gjirokaster. Njëkohësisht lindje në Përmet nuk po realizohen prej shumë kohësh, e si rrjedhim mungon në mjet identifikimi vendlindja Përmet. Janë bërë shumë diskutime për këtë çështje, por pavarësisht dëshirës së mirë nga ana e bashkisë, kjo çështje nuk varet nga ne.

4.6- Ekonomia

Sektorët si bujqësia, blegtoaria, agroindustria, turizmi, tregtia dhe shërbimet përbëjnë drejtimet ekonomike në të cilat është e përfshirë popullsia lokale. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Sektori i shërbimeve punëson numrin më të madh të forcës aktive të punës, pas këtij renditet bujqësia. Edhe pse Bashkia ka profil bujqësor, sektori i shërbimeve përfaqëson numrin më të lartë të punësimit, bujqësia përfaqëson sektorin kryesor ekonomik. Pjesa më e madhe e fermave janë të vogla dhe kryesisht familjare. Numri i ndërmarrjeve aktive në vitin 2024 është 226.

Tabela 8 - Profili ekonomik i Bashkisë Përmet

Numri i Bizneseve (Gjithsej)	Biznes i madh	Biznes i vogël	Numri i Fermave
480	56	424	-

Burimi: Bashkia Përmet

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 81 biznese të reja ndërsa gjatë vitit 2023 operojnë rreth 226 biznese. Grupi i prodhuesve të shërbimeve vazhdon të jetë mbizotërues në ekonominë lokale të bashkisë Përmet me rreth 95% të ndërmarrjeve aktive. Aktiviteti ekonomik “Tregtia me pakicë” përfaqëson 50% të ndërmarrjeve, ndërsa “akomodim dhe shërbimi ushqimor” i lidhur ngushtë me industrinë e turizmit përfaqëson 30%.

Tabela 9 -Numri i bizneseve të rregjistruara sipas viteve në Bashkinë Përmet

Ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik	2018	2024	2025
Totali	81	226	497
Ndërmarrje prodhuese			
• bujqësi		1	1
• industri	4	30	38
• peshkim			
Ndërmarrje shërbimesh			
• Tregëti	38	59	39
• Transport	14	26	30
• Akomodim dhe shërbim ushqimor	35	105	148
• Informacion e komunikim		5	5
• Të tjera			

Burimi: Bashkia Përmet (Sporteli i shërbimit të QKB-së në Bashki)

Ashtu siç tregohet edhe nga tabela e mësipërme, turizmi është një aktivitet ekonomik i rëndësishëm për bashkinë. Përmeti është vendi ideal për turizmin familjar dhe atë të aventurës. Megjithëse në hapat e para, zhvillimi i agroturizmit shihet si një oportunitet për punësimin e të rinjve ashtu edhe për rikthimin e familjeve që kanë emigruar nga zona.

Tabela 10 :Të dhëna mbi numrin e hoteleve dhe turistëve.

	2018	2023	2024
1 Hotele Guest house	9	75	136
2 Shtreter	201	500	1590
3 Turist	30000	50000	150000
4 Turist te huaj	10000	15000	50000
5 Turist vendas	20000	35000	100000







Tabela 11 :Të dhëna mbi relizimin e të ardhurave nga bizneset në tre vitet e fundit


VITI 2023		VITI 2024		VITI 2025		
Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	-
18 662	18 414	19 298	15 583	20 025	14 766	

Në formë grafike ky realizim paraqitet si më poshtë;





Në % ky realizim Për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:






Në % ky realizim për vitin 2024 paraqitet si më poshtë:





Në % ky realizim për vitin 2025 paraqitet si më poshtë:



4.7- Punësimi dhe papunësia

Statistikat e tregut të punës janë thelbësore për hartimin e Planit të Kujdesit Social. Shkalla e punësimit (raporti i të punësuarve kundrejt popullsisë në moshë pune), dhe ajo e papunësisë (raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës) janë tregues social kyç. Ky seksion i dokumentit siguron informacion mbi të dhënat e punësimit dhe papunësisë kryesisht nga Zyra e Punës Përmet.

Sipas Zyrës së Punës, numri i të papunëve në vitin 2022 ishte 956, nga të cilët 416 (44%) jetonin në zonat rurale, 428 (45%) ishin gra, 146 (15%) persona me aftësi të kufizuara, 21 (2%) egjiptianë, 13 (1%) emigrantë të kthyer, dhe 17 (2%) gra kryefamiljare.

Tabela më poshtë paraqet numrin e të papunëve sipas gjinisë dhe nivelit arsimor.

Tabela 11 - Papunësia sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor	Femra	Meshkuj	TOTALI
Pa arsim	3	0	3
Fillore	6	5	11
9-vjeçare	232	262	494
E mesme e përgjithshme	160	190	350
E mesme profesionale	20	20	40
Arsimi universitar	23	35	58
TOTAL	444	512	956

Burimi: Bashkia Përmet




Tabela më poshtë jep informacion për numrin e të papunëve sipas njësive administrative.

Tabela 11: Të dhëna mbi papunësinë sipas njësive administrative

Njësia administrative	Femra	Meshkuj	Totali
Përmet	239	301	540
Petran	66	67	133
Çarçovë	108	101	209
Frashër	5	6	11
Piskovë	26	37	63
Totali	444	512	956

Burimi: Bashkia Përmet





V. DREJT NJË STRATEGJIE PËR TURIZMIN NË PËRMET

Strategjia dhe Plan i Veprimit për Turizmin në Përmet (SPVT) është krijuar nga një proces bashkëpjesëmarrës duke përfshirë analiza të tregjeve ekzistuese të turizmit dhe atyre me mundësi zhvillimi në Përmet, pasuritë dhe nevojat, marrëveshjet mbi objektivat dhe qëllimet strategjike dhe identifikimin e një programi aktiviteteve për t'i realizuar ato. Për këtë është ndjekur procesi i mëposhtëm me këtë rend.

- Marrja e informacionit dhe e mbështetjes për bashkinë e Përmetit.
- Organizimi i një takimi fillestar me aktorë lokal.
- Formimi i një Komiteti Veprimi për Turizmin (KVT).
- Caktimi i një stafi për të mbështetur procesin e planifikimit.
- Ndërmarrja e një studimi të tregut të Përmetit.
- Marrja e informacioneve nga publiku/aktorët mbi projekt SPVT-në.
- Përfshirja e informacionit nga publiku dhe zhvillimi i SPVT-së përfundimtare
- Marrja e aprovimit të SPVT-së nga Bashkia e Përmetit.

SPVT-ja e Përmetit ofron një kuadër pune për bizneset, qeveritë dhe organizatat përkatëse për të analizuar tregjet e turizmit, pasuritë e turizmit dhe problematikat e tij në mënyrë që të hartohen objektiva që shtojnë pasuritë dhe i kapërcejnë këto problematika. Plan i do të monitorohet dhe të vlerësohet rregullisht në mënyrë që të kryhen rishikime të nevojshme.

SPVT-ja e Përmetit ka si qëllim të jetë një plan "pune" i ndryshueshëm dhe evolues. SPVT-ja është në formatin e një dokumenti me lidhje që lejon shtimin/heqjen e materialeve, futjen e rezultateve të regjistruara, objektivave gjatë zbatimit dhe përfshirjen e ndonjë rishikimi të nevojshëm që del gjatë punës së zbatimit.

5.1-Vizioni për turizmin shqiptar (2025-2030)

Shqipëria njihet si një destinacion i sigurtë turistik me vlera të mëdha, e cila karakterizohet nga një larmishmëri unike me vende natyrore dhe kulturore të një niveli botëror që gjenden brenda një hapësire relativisht të vogël gjeografike, e cila menaxhohet në mënyrë të përgjegjshme nga ana mjedisore dhe sociale, që është lehtësisht e shfrytëzueshme nga tregjet europiane turistike.

Përtej vështirësive që ju imponuan sektorit të turizmit, pas situatës dramatike të tërmetit të Nëntorit të vitit 2019 dhe ciklëve të njëpasnjëshme të pandemisë së Covid 19, që kulmuan përgjatë vitit 2020 me një rënie prej rreth 60% të numrit të vizitorëve dhe turistëve, industria e turizmit po konsolidohet me një ritëm të qëndrueshëm, si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit. Bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT, viti 2021 mund të konsiderohet si viti i rikthimit gradual në normalitet, pas kontraktimit të thellë ekonomik të shënuar gjatë vitit 2020, si pasojë e masave për përballimin e pandemisë Covid-19, duke regjistruar rreth 5,7 milionë turistë të huaj që vizituan Shqipërinë dhe që arriti në 90% numrin e vizitorëve të shënuar në vitin 2019, si viti më i mirë para nisjes së krizës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030, e pozicionon Shqipërinë në vendin e

14-të në botë për kontributin në ekonomi të industrisë së turizmit dhe sipas Indeksit të Zhvillimit të Udhëtimeve dhe Turizmit 2021 të Forumit Ekonomik Botëror (ĒEF) një nga tre vendet evropiane së bashku me Malin e Zi dhe Kroacinë, me varësinë më të lartë nga ky sektor. Gjithashtu, kjo industri, e mirënjohur si punësues intensiv, siguroi punësimin në gjithë zinxhirin e vlerës së turizmit të rreth 226 mijë punonjësve, duke zënë rreth 20 % të numrit të të punësuarve. Përgjatë po të njëjtit vit, të ardhurat e siguruar nga “Turizmi hyrës” i jorezidentëve, arritën në nivelin e 2,4 miliard USD, të cilat përbënë rreth 83% të eksporteve shqiptare dhe në të njëjtën kohë luajtën një rol të rëndësishëm në bilancin e pagesave. Sa i takon investimeve në turizëm, ato arritën përgjatë vitit 2021 në nivelin e rreth 210 milion USD dhe përbënë rreth 7.5% të të gjitha investimeve në vend. Sipërmarrjet e akomodimit dhe të shërbimeve në funksion të turizmit në vitin 2021 sipas Regjistrisë të Biznesit të INSTAT, numëronin rreth 19,000 njësi, Sektori i shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit, që përfshin restorantet, struktura të tjera ushqimi si dhe struktura akomoduese të tipit hotel, bujtinë, hostel etj, përbën rreth 17.5% të gjithë sektorit të shërbimeve si dhe 10.6% të të gjitha aktiviteteve në Shqipëri. Europa është burimi kryesor i turistëve që vizitojnë Shqipërinë, duke zënë një volum prej rreth 91 % të të gjithë turistëve, çka reflekton se aksesin nën 3 orë nga një destinacion në tjetrin është ende faktor i rëndësishëm për fluksin e udhëtarëve për qëllime turizmi. Megjithatë së fundmi turistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina apo vende të tjera të Azisë dhe Lindjes së Mesme, kanë shënuar një interes domethënës rritës, duke inkurajuar kështu indirekt zhvillimin e segmenteve të turizmit, sidomos turizmin historik dhe atë kulturor. Paralel me objektivin për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në mbrojtje dhe ruajtje të traditave dhe vlerave kulturore, historike, natyrore etj., synimi është pasja e një turizmi gjithëvjeter dhe me shtrirje gjeografike me qëllim rritjen e vlerës së shtuar dhe impaktit pozitiv të sektorit në zinxhirin e zhvillimit ekonomik.

5.2-Qëllimet strategjike kombëtare. Qëllimet do të përqëndrohen në: **1.** Zhvillimin e shërbimeve që lidhen me aktivitetet e turizmit natyror dhe nxitjen e zhvillimit të festave dhe eventeve në destinacione; **2.** Nxitjen e përgatitjes dhe miratimit të planeve të zhvillimit të territorit, mbështetjen e projekteve për rigjenerimin e territoreve urbane, zbatimin e investimeve që përmirësojnë infrastrukturën lidhëse nga qendrat urbane apo rurale në drejtim të zonave me interes për tu vizituar; **3.** Zbatimin e investimeve që i kthejnë zonat e mbrojtura në parqe natyrore, me infrastrukturë të përshtatshme për vizitueshmërinë e tyre, në qendra të edukimit të rinjve, ku mbështetet kërkimi shkencor dhe ku krijohet ekonomi e qëndrueshme. **4.** Zbatimin e investimeve që lidhen me përmirësimin e aksesit në pikat hyrëse-dalëse tokësore, përmirësimin e korridoreve rrugore, ndërtimin e porteve, ndërtimin e aeroporteve, ndërtimin e hekurudhave, ndërtimin e stacioneve multimodale dhe përmirësimin e shërbimeve të transportit urban dhe ndërqytetas; **5.** Alokimin e burimeve njerëzore dhe finaciare të nevojshme, për përmbushjen e sigurisë fizike, ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit, furnizimin me ujë, furnizimin me energji, administrimin e mbetjeve; **6.** Nxitjen dhe zhvillimin e rrjeteve digjitale dhe shërbimeve që burojnë prej tyre, duke bashkërenduar me sektorin privat të turizmit, ofruesit e teknologjive dhe inovatorët; **7.** Nxitjen dhe mbështetjen e projekteve kombëtare dhe transnacionale që synojnë adresimin e pasojave të ndryshimit të klimës dhe emetimit të CO₂, duke përfshirë rrugët tematike kombëtare, rrugët kulturore të Këshillit të Evropës, rrugët çiklistike pjesë të korridorit evropian EUROVELO , **8** infrastrukturën për ushtrimin e sporteve për argëtim, zhvillimin e strukturave pritëse turistike me performacë të lartë mjedisore; **9.** Ngritjen e një sistemi kombëtar të edukimit turistik, kurrikulave profesionale bashkëkohore.





5.3-Plani strategjik i Përmetit për zhvillimin social dhe ekonomik 2025-2030

Identifikon zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit si një objektiv me përparësi për rritjen e ekonomisë lokale. Plani për Përmetin me një komunitet që gëzon zhvillim në harmoni dhe mundësi të barabarta, një qendër turizmi ndërkombëtar me një ekonomi dinamike bazuar në konsolidimin e agroturizmit, vreshtaria dhe kulinaria.

Rëndësia e zhvillimit të turizmit në harmoni me vlerat kulturore, historike, etnografike dhe natyrore të qytetit është përfshirë në objektivin e parë strategjik të planit.

Objektivi Strategjik 1	Një qendër ndërkombëtare kulturore e mbështetur nga turizmi ku hotelet ofrojnë fjetje dhe mëngjes, i cili ruan dhe zhvillon trashëgiminë unike kulturore, historike dhe arkitekturore të qytetit.
Objektivi Strategjik 2	Zhvillimi i harmonizuar i ekonomisë së qytetit, i cili konkuron në tregun rajonal përmes zgjerimit të agroturizmit, vreshtaria dhe kulinarisë, dhe ku nxiten diversiteti dhe cilësia.
Objektivi Strategjik 3	Zhvillimi i ekuilibruar i territorit urban që krijon një mjedis bashkëkohor dhe në harmoni me tiparet dhe trashëgiminë specifike të qytetit.
Objektivi Strategjik 4	Një jetë sociale me cilësi të lartë, dinamike dhe gjithëpërfshirëse ku mundësitë e barabarta për përparim dhe mirëqenie mbështeten dhe rriten për të gjithë.

Objektivat Strategjike për zhvillimin social-ekonomik të paraqitura më poshtë me hollësi .

5.3.1 Objektivi Strategjik 1

Qëllimi	Aktivitetet kryesore	Aktorët	Afati	Indikatorët
: Rritja e imazhit të qytetit si destinacion kulturor ndërkombëtar	1-Restaurimi i monumenteve historike dhe krijimi i një muzeu interaktiv lokal.	Bashkia, Ministria e Kulturës dhe Mjedisit, Agjencitë e Turizmit, bizneset hoteliere.	1-2026-2028	Rritja e numrit të vizitorëve ndërkombëtarë, rritja e net-qëndrimeve në hotele, rritja e të ardhurave nga turizmi kulturor.
	2-Organizimi i festivaleve vjetore kulturore ndërkombëtare (muzikë, art, kulinari)		2-2026-2030	
	3-Certifikimi i hoteleve dhe bujtinave me standarte "Bed & Breakfast Quality Mark".		3-2027-2030	
	4-Trajnime për operatorët turistikë mbi pritjen e vizitorëve ndërkombëtarë.		4-Çdo vit	
	5-Hartimi i një brand- turistik të qytetit (logo, slogane, paketim kulturor).		5-2025-2027	

5.3.2 Objektivi Strategjik 2

Qëllimi	Aktivitetet kryesore	Aktorët	Afati	Indikatorët
Diversifikimi i ofertës turistike duke lidhur turizmin me bujqësinë dhe kulinarinë.	1-Krijimi i rrugës së verës dhe ushqimit tradicional (wine & food route). 2-Mbështetje me fonde për hapjen e fermave të agroturizmit dhe bujtinave. 3-Panaire të përvitshme të produkteve bujqësore dhe artizanale. 4-Trajnime për fermerët mbi marketingun rural dhe certifikimin bio. 5-Promovimi i kuzhinës lokale në paketat turistike (menutë tradicionale).	Bashkia, Ministria e Bujqësisë,bizneset private,shoqatat e fermerëve.	1-206-2029 2-2025-2030 3-çdo vit 4-206-2027 5-2026	Numri i fermave agroturistike të certifikuara,shitjet e produkteve bio,numri i turistëve që marrin pjesë nëerienat kulinare.

5.3.3 Objektivi Strategjik 3

Qëllimi	Aktivitetet kryesore	Aktorët	Afati	Indikatotrët
Ndërtimi një qyteti modern pa humbur identitetin tradicional	1-Hartimi i planit rregullues urban me standarte bashkëkohore. 2-Restaurimi i fasadave tradicionale dhe ndalimi i ndërtimit pa leje. 3-Krijimi i hapsirave publike të gjelbra (parqe,shëtitore). 4-Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës turistike. 5-Zhvillimi i transportit miqësor me mjedisin (biçikleta)	Bashkia, Ministria e Infrastrukturës,arkitektë urbanistë,komuniteti.	1-2026-2028 2-2025-2030 3-2026-2030 4-2025-2027 5-2026-2030	Sipërfaqe e hapësirave të gjelbra,numri i ndërtesave të restauruara,përmirësimi i aksesit dhe transportit.





5.3.4 Objektivi Strategjik 4

Qëllimi	Aktivitetet kryesore	Aktorët	Afati	Indikatorët
Rritja e cilësisë së jetës për qytetarët dhe turistët përmes shërbimeve sociale dhe aktiviteteve kulturore.	1-Krijimi i qendrave komunitare për kulturë, sport dhe edukim.	Bashkia, shoqatat e shoqërisë civile, organizatat rinore, institucionet arsimore.	1-2026-2028	Numri i aktiviteteve kulturore, niveli i kënaqësisë së qytetarëve, pjesëmarrja e grupeve vulnerabël në jetën sociale.
	2-Organizimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse (koncerte, kinema verore, aktivitete rinore).		2-çdo vit	
	3-Mbështetje për grupet vulnerabël (gra, të rinjtë, të moshuarit).		3-2026-2029	
	4-Zhvillimi i programeve të turizmit social për grupe me të ardhura të ulëta.		4-2026-2028	
	5-Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe edukative.		5-2025-2026	

5.4-Pushteti lokal dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me turizmin

Njësitë e qeverisjes lokale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, janë përgjegjëse për:

- inventarizimin e burimeve kryesore turistike në territorin e njësive të pushtetit lokal dhe të bizneseve turistike lokale;
- dërgimin, periodikisht, dy herë në vit të inventarëve të përmendur më sipër Ministrisë përgjegjëse për turizmin, në mënyrë që të krijojë një bazë të dhënash në nivel kombëtar;
- ofrimin e asistencës teknike për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të turizmit në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- monitorimin e respektimit të këtyre dispozitave të ligjit dhe ligjeve të tjera dhe akteve nën-ligjore nga kompanitë private që operojnë në fushën e turizmit dhe sugjerimin e hapave të nevojshëm që duhet të merren nga institucionet shtetërore përgjegjëse për turizmin.

5.5-Mbështetja për zhvillimin e turizmit

Institucionet shtetërore duhet, në përputhje me, dhe nën mbikqyrjen e Ministrisë përgjegjëse për turizmin, të mbështesin zhvillimin e turizmit duke:

- a. hartuar planet e zhvillimit turistik për secilën bashki dhe njësi administrative;
- b. ofruar informacione për turizmin, arsimim dhe aktivitete promovuese;
- c. marrë masa për të zhvilluar infrastrukturën dhe mjediset në zonat e zhvillimit turistik, fshatrat turistikë, vendet turistike dhe në objektet turistike.
- d. asistuar në investimet turistike në zonat e largëta malore, pak të populluara;
- e. propozuar stimuj fiskalë që duhet t'i jepen bizneseve të turizmit, individëve dhe personave juridikë në zonat e zhvillimit turistik, në fshatrat turistikë, vendet dhe objektet turistike.

5.6-Planifikimi për turizmin

Planifikimi i zhvillimit turistik duhet:

- a. të mbështetet në regjistrin kombëtar të burimeve turistike;
- b. të jetë në përputhje me planet e zhvillimit të turizmit në nivel kombëtar, bashki dhe në njësit administrative;
- c. të përqëndrohet në zonat me zhvillim turistik dhe ku zhvillimi turistik ka mundësi të nxitë më tej zhvillimin socialo-ekonomik;
- d. planet e zhvillimit turistik duhet të rishqyrtohen periodikisht dhe të rishikohen për të siguruar përputhshmërinë me situatën e zhvillimit socio-ekonomik në nivel kombëtar, rajonal dhe pushteti vendor.

Siç theksohet dhe në ligj, përfshirja e drejtpërdrejtë e sektorëve përkatës privatë, publikë dhe të OJQ-ve në të gjithë zonat rajonale dhe lokale në zhvillimin e potencialit turistik në Shqipëri është faktor kyç për suksesin e industrisë së turizmit të një vendi.

5.7- Turizmi në Përmet

Zhvillimi i turizmit në Përmet

Duke patur parasysh vlerat natyrore, historike, kulturore ky qytet vitet e fundit vizitohet shpesh nga turistë vendas dhe të huaj. Gjithashtu grupet e vizitorëve që vinin nga Kosova dhe nga rajoni





vizitojnë Përmetin gjatë tureve të organizuara. Numri i vizitorëve është rritur, me vizitorë që vijnë nga jashtë vendit, nga qytete të tjera të Shqipërisë, dhe nga Kosova. Për qytetarët e Përmetit kjo rritje vë në dukje më së miri përdorimin e pasurive të qytetit dhe pasqyron traditat e qytetit në mikpritjen e vizitorëve. Tradicionalisht në Përmet, vizitorët kanë gjetur mikpritjen, përvojën që të ofron një mjedisin i qetë dhe çlodhës si dhe mundësinë për të shijuar kuzhinën dhe potencial turistik në Përmet:

Mbështetur te sondazhet e vizitorëve

- 30 % janë nga Europa
- 20 % e turistëve janë shqiptarë që jetojnë në vende të tjera
- 10% e turistëve janë nga kontinente të tjera (duke përfshirë Azinë, Amerikën)
- 40% e turistëve janë shqiptarë (tregu i brendshëm)

5.8- Vendi i origjinës, moshë

Në vitin 2024 numri më i lartë i turistëve që vizituan Përmetin vinte nga tregu i brendshëm, Europa Perëndimore dhe lindore në veçanti Franca, MB, Italia, Gjermania, Polonia, Çekia nga Ballkani. Informatorë të tjerë vërejtën një rritje në numër të turistëve nga SHBA që vizitonin rajonin. Një pjesë e madhe e turistëve janë mbi moshën 45 vjeçare, edhe pse ka interes gjithashtu nga tregun i më të rinjve (< 24 vjeçarët). Këto rezultate të mbështetur në sondazhet e bëra vizitorëve, mesatarja e qëndrimit në Përmet është 3 ditë. Vizitorët rrinë më gjatë në shtëpitë e pritjes me një mesatare prej 6 netësh. Ndryshe nga vizitorët që qëndrojnë në hotele të cilët rrinë pak më pak se 4 netë dhe ata që bëjnë kamping qëndrojnë mesatarisht 2 netë. Akomodimi është shpenzimi kryesor gjatë një vizite në Përmet, duke vazhduar me ushqimet dhe pijet dhe me blerjen e suvenireve. Më shumë se 4000 lekë shpenzohet për artikuj të tjerë ata pasqyrojnë atë çfarë Përmeti i ofron turizmit, pra histori, kulture, natyrën dhe aktivitete mbështetur në aventurë, kulturë, histori, natyrë, kulinari.

5.9-Tregu i Brendshëm

Tregu i brendshëm aktualisht është një treg i gjerë për Përmet. Ndërsa është e vështirë që të jepet një shifër e saktë e këtij tregu, të intervistuarit vërejtën që ka pasur një rritje të konsiderueshme të hyrjeve në tregun e brendshëm dhe gjithashtu të shqiptarëve që vinë nga vendet fqinje (shihni më poshtë). Ka një sërë nën-ndarjesh brenda tregut të brendshëm:

- familje që zgjedhin të kalojnë kohën në këtë zonë
- të rinjtë dhe grupet nga shkollat
- vizitorë në moshë të mesme dhe të moshuar që janë turistë të pavarur.

- njerëz që vizitojnë miq dhe të afërm
- turistë për biznese
- turistë lokalë nga zona rreth Përmetit, që e vizitojnë për arsye të ndryshme;



VI. KONKURRENCA

Në zhvillimin e Përmetit si një destinacion turizmi, është e rëndësishme që të ketë një njohje të plotë të konkurrentëve të tregut. Analiza e konkurrentëve bën që Përmeti të njohë pozicionin e tij si destinacion turistik në tregun vendas, bën që të fitojë mundësi të reja që të jenë në përputhje me pikat e forta të tij dhe me unifikimin si markë tregtare (USP), për ta bërë të dallueshëm nga konkurrentët e tij dhe të pozicionohet me shumë sukses.

Mbështetur në studimin e plotë dhe studimet bazë, Komiteti i Veprimit për Turizmin doli në përfundimin se kishte konkurrues sipas pozicionit gjeografik (sa të shfrytëzueshme janë), sipas ofertave të tyre turistike, pikave të forta dhe të dobëta, dhe sipas tregjeve të tyre aktuale. Destinacione

Table 1: Analiza e konkurrentëve

Konkurrentët sipas renditjes		Koment
1	Rajoni i Korçës	➤ Konkurrent i rëndësishëm. ➤ Zhvillim turistik të koordinuar dhe të përqendruar gjatë viteve të fundit. ➤ Produkt turistik kulturor. ➤ Vizitohet nëpërmjet Greqisë dhe Maqedonisë (Ohër). ➤ Rritje e interesit të turistëve për këtë destinacion. ➤ Interesi i tregut europian po rritet në Rajonin e Korçës.
2	Qyteti i Gjirokastrës	➤ Një vend që mbrohet nga UNESCO-ja për shkak të arkitekturës ➤ Nivel i ngjashëm i zhvillimit dhe i promovimit turistik. ➤ Standarde të ngjashme të produktit turistik. ➤ Aktivitete të projekteve ndërkombëtare për të përmirësuar infrastrukturën, produktet turistike dhe shërbimet. ➤ Zhvillim i planifikuar dhe i koordinuar turistik. ➤ Mundësi të shfrytëzimit të tregjeve nga Greqia.
3	Rajoni i Kolonjës	➤ Afërsi më e madhe me Korçën dhe Pogradecin.



		➤ Pjesë e tureve të rajonit të Korçës. ➤ Produkte suvenire të përpunuara. ➤ Mundësi të kufizuara për akomodim.
3	Saranda Dhe Vlora	➤ Destinacionet e plazhit me mundësi të përdorimit të tregjeve kryesore (afër porteve detare dhe aeroportit të ri të Vlorës), infrastrukturë shumë të mirë të rrugëve ➤ Oferta të mira akomodimi. ➤ Tregje të mira për grupet turistike. ➤ Kombinim i plazhit dhe i pasurive kulturore (romake, Ilire). ➤ Kohët e fundit po tërheq tregun rajonal (Vlorë-Sarandë). ➤ Vend që mbrohet nga UNESCO-ja (Saranda) që mund të vizitohet gjatë udhëtimeve ditore nga tregjet kryesore.
5	Greqia	➤ Turizëm kulturor duke përfshirë vendet e UNESCO-s ➤ Turizëm i zhvilluar (veçanërisht Greqia) duke përfshirë produkte, shërbime dhe një promovim shumë të mirë. ➤ Lehtësisht i shfrytëzueshëm. ➤ Të përqendruar në tregjet e ndryshme.

Pikat e dobëta dhe të forta

Një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të Përmetit u krye gjatë workshopit të parë dy-ditor të Komitetit të Veprimit të Turizmit. Ai vijoi më tej gjatë workshopit të dytë me analizën përfundimtare që mbështetej në identifikimin e pasurive kryesore dhe të problematikave që lidheshin me zhvillimin e turizmit në Përmet. Këto u renditen sipas fushave të elementëve turistike më të rëndësishëm dhe pastaj u radhitën më vete sipas rëndësisë së tyre.

Katër pikat e forta dhe të dobëta për secilin element janë të paraqitura në tabelën 2.

Table 2: Analiza e pasurive dhe problematikave të turizmit

	Pikat e forta	Pikat e dobëta
Objektet turistike	➤ trashëgimi i pasur natyrore, kulturore, historike ➤ Ndërtesa karakteristike ➤ muzeu vendor dhe sala e Kongresit.	➤ mungesa e mirëmbajtjes apo dëmtimi i pasurive kulturore/historike ➤ muzeu i vëllezërve Frshëri dhe kishat në Njësitë Administrative kanë nevojë për rikonstrukcion

Infrastruktura	➤ Funksionimi i Zyrës së Shërbimit Turistik gjatë sezonit turistik ➤ Identifikim i standardizuar i turistëve. ➤ Qëndër informacioni turistik për lumin Vjosë tek guri i qyteteit ➤ energji elektrike 24 orë, pa ndërprerje	➤ mungesa e vendeve të parkimit publik dhe e vendeve për karvane ➤ mungesa e unazës për të zvogëluar lëvizjen e automjeteve të rënda në qytet 
Kapacitetet njerëzore	➤ § bashkëjetesë fetare dhe kulturore ➤ banorë mikpritës	➤ mangësi e një stafi pritës të trajnuar ➤ mungesa e aftësive të menaxhimit të bisneseve në turizmin lokal
Shërbimi tregtar	➤ restorante të mira, kulinari ➤ adresa e internetit e bashkisë	➤ Mungesa e jetës së natës ➤ punësimi në biznesin e turizmit nuk shihet si një mundësi karriere (p.sh. pagat e ulëta)
Imazhi dhe Promovimi	➤ është pjesë e itinerareve të tureve kombëtare dhe ndërkombëtare ➤ organizimi i aktiviteteve gjatë vitit ➤ ekspozim pozitiv përmes organizimit të festivaleve dhe aktiviteteve	➤ mungesa e paketave turistike cilësore

.VII. STRATEGJIA E TURIZMIT PËR PËRMETIN

Kjo strategji përcakton Vizionin dhe objektivat tona për zhvillimin e turizmit në Përmet për 5 vitet e ardhshme deri në vitin 2030. Ky vizion mbështetet në parimet e Cilësisë dhe Qëndrueshmërisë – cilësia dhe vlerat mbështetur në eksperiencën e vizitorëve; produktet dhe shërbimet me cilësi që paraqesin vlerën e Përmetit; në harmoni me mjedisin; dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për qytetarët e Përmetit – këto gjëra, së bashku, do të sigurojnë qëndrueshmërinë e turizmit në Përmet Mbështetja në parimet e turizmit të qëndrueshëm



Zhvillimi i turizmit në Përmet do të mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë. Turizmi i qëndrueshëm mund të përkufizohet si: *Turizëm që merr plotësisht parasysh ndikimet aktuale dhe të së ardhmes në fushën ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke trajtuar nevojat e vizitorëve, industrinë, mjedisin dhe komunitetet pritëse. Përkufizimin e Organizatës Botërore të Turizmit të OKB-së për (OBTKB) për turizmin e qëndrueshëm mund ta gjeni më poshtë.*

Përkufizimi i OBTKB-së për turizmin e qëndrueshëm

Parimet e qëndrueshmërisë i referohen aspekteve mjedisore, ekonomike, socio-kulturore të zhvillimit të turizmit, dhe ndërmjet këtyre tre fushave duhet vendosur një ekuilibër i përshtatshëm për të garantuar një qëndrueshmëri afatgjatë.

Prandaj, turizmi i qëndrueshëm duhet:

1. Të shfrytzojë në maksimumi burimet mjedisore që janë një element i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, duke ruajtur proceset e rëndësishme ekologjike dhe duke ruajtur burimet natyrore dhe biodiversitetin.
2. Të respektojë identitetin socio-kulturor të komuniteteve pritëse, të ruajë ndërtesat e tyre, trashëgiminë kulturore dhe vlerat tradicionale, dhe të japë kontributin në mirëkuptimin dhe tolerancën ndër-kulturore.
3. Të sigurojë veprimtari ekonomike praktike afatgjatë, duke ofruar përfitime socio-ekonomike të barabarta për të gjithë aktorët e përfshirë, duke ofruar një punë të qëndrueshme, mundësi për të siguruar të ardhura dhe shërbime sociale për komunitetet pritëse, duke sjellë uljen e varfërisë.

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm kërkon pjesëmarrjen e vazhdueshme të të gjithë aktorëve të rëndësishëm, gjithashtu dhe të lidërshit politik për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë dhe krijimin e një konsensusi. Arritja e një turizmi të qëndrueshëm është në proces i vazhdueshëm dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm të rezultateve, duke marrë masa të nevojshme parandaluese dhe/apo korrigjuese kur është e nevojshme. Turizmi i qëndrueshëm duhet gjithashtu të ruajë një nivel të lartë të numrit të turistëve të kënaqur dhe t'i sigurojë atyre një eksperiencë të paharrueshme, nëpërmjet rritjes së sensibilitetit rreth çështjeve të qëndrueshmërisë dhe promovimit të praktikave të qëndrueshme turistike.

Rruga drejt së ardhmes

Vizioni i Strategjisë dhe i Planit të Veprimit për Turizmin në Bashkinë Përmet mbështetet në rolin që sektori i turizmit do të luajë në zhvillimin e qëndrueshëm të Përmetit. Objektivi është që Përmeti të zhvillohet si një destinacion me cilësi të lartë, duke tërhequr një numër shumë të madh turistësh që sjellin të ardhura të larta nga bota me interesa për kulturën dhe natyrën.

Në periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesme, do të mbështetemi në pasuritë tona ekzistuese të prekshme dhe të paprekshme trashëgimore dhe kulturore. Fokusi jonë do të jetë rindërtimi ose përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese; duke forcuar kapacitetet e burimeve tona njerëzore; përmirësimin e cilësisë së akomodimit, objektet turistike, restoranteve dhe suvenireve; njohje më të



mirë të tregjeve tona aktuale dhe potenciale; dhe rritje të sensibilizimit të turistëve dhe industrisë së turizmit në Përmet si një destinacion cilësor.

Në periudhën afat-mesme dhe afatgjatë, do të fokusohemi në zgjerimin e shkallës së produkteve dhe të shërbimeve që u ofrohen turistëve. Ne do t'i kushtojmë vëmendje investimeve në produktet dhe shërbimet turistike që ofrojnë eksperiencë unike dhe mundësojnë zhvillimin që është në harmoni me mjedisin natyror dhe social të Përmetit dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve tonë. Synimi jonë është kombinimi i kulturës, trashëgimisë dhe natyrës sonë në eksperiencat turistike. Fokus ynë do mbetet gjithmonë cilësia para sasisë. Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë kapacitetet e burimeve njerëzore dhe tregun efektivisht drejt tregjeve që synojmë të arrijmë. Gjithashtu, do ta rishqyrtojmë dhe rishikojmë këtë strategji periodikisht dhe do të

planifikojmë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit përtej vitit 2030.

Tregjet e synuara

Gjatë zhvillimit të turizmit në Përmet fokusi do të jetë në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve që plotësojnë nevojat e tregjeve të synuara. Si pjesë e këtij procesi planifikimi KVT-ja identifikoi pesë tregje që synojmë të arrijmë në një të ardhme afatshkurtër dhe afatmesme. Tregjet e synuara pasqyrojnë përqëndrimin në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme në kulturë dhe trashëgimi, kombinimin për një periudhë afatgjatë të kulturës dhe trashëgimisë me natyrën dhe produktet e aventurës dhe me nevojat e vazhdueshme për të tërhequr dhe për t'u shërbyer asaj pjese të grupeve turistike ndërkombëtare dhe turistëve vendas që sjellin të ardhura më të mëdha. Tregjet e synuara janë si më poshtë:

Të apasionuarit pas kulturës: turistë që janë të interesuar në destinacione të reja që kanë si qëllim kryesor të udhëtimit të tyre përvojën e një kulture të re. Të apasionuarit pas kulturës shumë të interesuar për ato që ofron Përmeti dhe kanë gjasa të qëndrojnë më gjatë duke eksploruar rajonin. Të apasionuarit pas kulturës dëshirojnë një përvojë të veçantë dhe origjinale. Ata shfaqin interes për kulturën lokale, artet, artistët, argëtuesit, arkitekturën dhe traditat – të gjitha këto pasuri që Përmeti i ka.

Moderatorë të kulturës: udhëtarët që janë të interesuar në përfshirjen e aktiveteve kulturore si pjesë e eksperiencave të mëdha të udhëtimeve. Moderatorët e kulturës do të vizitojnë Përmetin si pjesë e itinerarit të gjatë të Ballkanit ose të Shqipërisë. Ata mund të udhëtojnë në grupe dhe mund të futen përmes agjencive turistike.

Turistë në kërkim të aventurave : udhëtarë të pavarur të cilët dëshirojnë të zbulojnë destinacione 'të veçanta'. Aventurat e thjeshta janë eksperiencë që shkojnë përtej itinerareve të zakonshme turistike, dhe zakonisht kombinohen me aktivitetet fizike dhe eksperiencat kulturore. Turistët që kërkojnë këto aventura preferojnë aktivitete ditore fizike duke u rikthyer në darkë në krevatin e tyre. Aventurat e thjeshtë është një nga segmentet që po zhvillohet më shpejt në industrinë e udhëtimit dhe preferohet nga ata që kërkojnë diçka më tepër se sa pushimet e zakonshme.



Grupe turistike ndërkombëtare dhe turistët grand : Përmeti bën pjesë në itinerarin e disa tureve ekzistuese. Ekziston mundësia për ta zgjeruar këtë treg me një fokus të veçantë në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve gjatë pranverës dhe vjeshtës. Tërheqja e grupeve turistike ndërkombëtare mund të sigurojë qëndrueshmëri të disa bizneseve duke mundësuar përfshirjen në tregje të reja.

Rikthimi në origjinë: Tregu i 'rikthimit të rrënjët e vjetra' i referohet atyre turistëve të cilët udhëtojnë për të zbuluar trashëgiminë e tyre etnike dhe gjeografike. Aktualisht, shqiptarët që jetojnë në rajonet e ballkanit dhe diaspora. Siç pritet ky treg do të vazhdojë të jetë një burim i rëndësishëm i vizitorëve në të ardhmen dhe është e rëndësishme të njihen nevojat dhe pritshmëritë e tyre dhe të zhvillohen produktet dhe shërbimet kryesore. Gjithashtu është edhe mundësia që nga ky treg të nxiten investimet në Përmet, sidomos nga emigrantët nga zona e Përmetit.

Tregu i brendshëm: Edhe pse rritja e tregut të brendshëm nuk shihet si një prioritet i komunitetit të Përmetit në këtë fazë, ky treg duhet të merret parasysh për një periudhë afatgjatë për disa arsye. Së pari, klasa e mesme që vjen nga qytetet kryesore të Shqipërisë si Tirana, Shkoder, Elbasan dhe Korça janë të interesuar që të zbulojnë historinë, kuzhinën lokale dhe të marrin pjesë në aktivitetet natyrore dhe të aventurës. Së dyti, festivalet e organizuara në Qytetin e Përmetit po fitojnë një emër të mirë në të gjithë vendin dhe kanë filluar të tërheqin turistët vendas. Së fundi, duke u mbështetur në eksperiencat e tjera, me kalimin e kohës tregu i brendshëm pritet të jetë më i qëndrueshëm se sa tregu ndërkombëtar. Sipas kësaj kur flitet për tregun e brendshëm, është e rëndësishme që segmentet e tregut dhe zhvillimi i produkteve të jenë të lidhura me nevojat dhe kërkesat e turistëve ndërkombëtarë të synuar. Për këtë duhet shmangur çdo konflikt i mundshëm.

Oferta turistike

Për t'i ardhur në ndihmë planifikimit për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Përmet dhe për identifikimin e tregjeve kryesore, u krye një rishqyrtim i ofertës turistike ekzistuese për produkte dhe shërbime turistike. Analiza e ofertës u përqëndrua në akomodimin, shërbimin e ushqimit dhe të pijeve, objekteve turistike, aktivitetet dhe festivalet.

Ushqimi dhe pijet

Në Përmet ka rreth 148 restorante që i shërbejnë turistëve. Ata ofrojnë kuzhinë tradicionale. Në këto restorante, gatohen dhe shërbehen gjellë tradicionale nga zona e Përmetit duke përdorur prodhime bujqësore vendase. Gjella më e njohur dhe karakteristike për Përmetin është 'Shqeto dhe supë me thërrime' një mënyrë tradicionale e gatimit. Produktet e përdorura janë zakonisht organike dhe lokale, me shije të veçantë. Vera dhe rakia (pije alkoolike tradicionale shqiptare) e kësaj zone është gjithashtu e pranishme.

Festivalet dhe aktivitetet: Përmeti organizon disa festivale dhe aktivitete gjatë gjithë vitit. Disa nga këto mbështeten në traditën dhe fenë dhe janë pjesë e trashëgimisë kulturore të rajonit. Deri tani, pjesa më e madhe e aktiviteteve kanë përfshirë popullsinë lokale. Ekziston mundësia që të

promovohen këto aktivitete për vizitorët e mundshëm dhe që të organizohen aktivitete të reja për të tërhequr vizitorët gjatë vitit.



Objektet turistike: Përmeti njihet për objektet historike, kulturore, natyrore e fetare.

- ✓ Muzeu Vendor ku përfshihen: pavioni etnografik, artizan, vllazërit Frashëri, Odise Paskali. Ndodhet në qendër të qytetit në godinën e QMF.
- ✓ Salla e Kongresit dhe pavioni i LANÇ që ndodhet brenda tij, ndodhet në lagjen e Re.
- ✓ Qendra Historike e qytetit të Përmetit shtrihet rrëzë malit Dhëmbel, përfshin të gjitha ndërtimet ekzistuese dhe shtrihet kryesisht në lagjet e Shënkollit (Varrosh), Teqesë, të cilat për nga kompozimi i ndërtimeve dhe rrugëve me kalldrëm, janë lagjet ku kanë mbetur gjurmët më të vjetra të qytetit.

Brenda qendrës historike ekzistojnë dy objekte kulti: Kisha e Shën e Premtes, e ndërtuar në vitin 1776, dhe e shpallur monument kulture e kategorisë së parë; Kisha e Shën Kollit e shekullit 19-të. Gjurma e rrugës e rrugicat e ngushta me kalldrëme ka të dhëna që i takojnë fillimit të shekullit të 19-të. Në Përmet ka banesa karakteristike ndonëse të transformuara, porta të harkuara dhe selvi shumë vjeçare.

Varroshi, që zakonisht përfshinte banesat përjashta fortesave, ato nën këmbët e kalasë, me kalimin e kohës njihet me emrin lagja e Shënkollit, sigurisht në kuptimin më të ngushtë, meqë kjo lagje fillonte të shtrihej nën këmbët e bregores së Bolëngës, nga fundi i së cilës ndodhej kalaja.

Kjo lagje ndërtuar thuhet nga ana jugore e Bolëngës, zbriste tatëpjetë lagjeve të tjera, mbi të cilat si pozicion mbizotëronte dhe kishte një hapësirë pamjeje të gjerë.

Rrugët janë të shtruara në pjesën më të madhe me kalldrëme të realizuar në gure gëlqerorë dhe gurë lumi. Dallohen disa tipologji dhe teknika shtrimi si ratë dhe këlliç. Në çdo shtrirje rrugore ekzistonte një linjë qendrore për kalimin e ujit, që pothuajse çdo ditë, hapej nga mullijntë për të garantuar pastrimin e rrugëve, portave dhe kopshteve.

Ndërtimet e banesave i janë nënshtruar spontanitetit, por edhe terrenit të pjerrët. Shtëpitë e kësaj lagjeje janë ndërtuar thuhet ngjitur njëra-tjetrës, me oborre ose kopështe të vegjël dhe me pjerrësi të lehtë që diktohet nga vetë terreni. Rrethimet e oborreve kryesisht janë të mbyllura nga mure guri të larta dhe porta druri me strehë. Shumica e banesave janë dykatëshe me mure guri dhe çati me rrasa guri, por nuk mungojnë dhe njëkatëshe ose dhe trekatëshe.



Brenda qendrës historike spikasin disa ndërtime të fillim shekullit 20-të me vlera të veçanta që meritojnë të marrin statusin monument kulture. Pjesa dërmuese e ndërtimeve janë të pas Luftës së Dytë Botërore.

Zona e Mbrojtur rrethon pjesën e Qendrës Historike dhe shtrihet në pjesën më të madhe në veri-perëndimore të saj.

Zona e Mbrojtur në pjesën më të madhe përbëhet nga një zonë e gjelbër kryesisht në kodrën e Bolëngës e cila është një zonë e qytetit me potencial të madh arkeologjik, si dhe përfshin edhe kalanë e Bolëngës si dhe disa banesa të ndërtuara në periudha të mëvonshme, me të cilat plotësohen më mirë vlerat e Qendrës Historike dhe krijohet një kalim i butë prej saj drejt pjesëve të planifikuara për ndërtime të reja.

Në përputhje me vlerat e çdo zone janë përcaktuar kriteret për ndërhyrjet konservuese dhe restauruese. Po kështu është planifikuar për t'u bërë dhe ndarja e monumenteve sipas kategorive që ndodhen në ansamblet e Qendrës Historike, zonës së mbrojtur apo në pjesët e tjera të qytetit dhe kriteret për ndërhyrjet në to.

Qendra historike ruan vlerat urbanistiko – arkitektonike të qytetit e cila ruan gjini të ndryshme ndërtimore si: ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore.

- ✓ Guri i qytetit monument natyre i kategorisë së parë që ndodhet jo larg nga qendrea e qytetit.
- ✓ Fshatrat turistike si; Leusë, Bënjë, Kosinë, Buhal, Frashër, Alipostivan në të cilat gjenden objekte historike dhe kulti.
- ✓ Kanioni i Lengaricës, ura e Katiut, Banjat termale të Bënjës me veti kurative të restauruara, shtrihen përgjatë luginës së Lengaricës 14 km larg qendrës së qytetit.
- ✓ Bredhi i Hotovës Park natyror kombëtar.
- ✓ Lugina e Vjosës Park natyror kombëtar.
- ✓ Cirkullinajor i Nemërçkës dhe ujëvara e Sopotit.

I-Analiza e kontekstit dhe potencialet lokale

- a) Pozicioni dhe roli i Përmetit në Strategjinë Kombëtare.
Përmeti bën pjesë në rajonin jugor, që nënvizohet në strategjinë kombëtare si një zonë me potencial të lartë për turizmin e qëndrueshëm, natyror, termal, kulturor, historik dhe agroturizmin.

b) Potencialet kryesore të turizmit në Përmet



Kategori	Shembuj
Turizmi natyrorë dhe aventurë	Parku kombëtar i urit Vjosë, banjat e Bënjës, Parku kombëtar Bredhi i Hotovës, hiking në Nemërçkë,
Turizmi kulturor dhe historik	Kisha e Kosinës, Leusës, Bënjës, teqeja e Alipostivanit, Frashërit shtëpia e vëllezërve Frashëri, guri i qytetit, muzeu vendor, monumente të LANÇ, veshjet etnografike të zonës, sazet
Turizmi shëndetësor dhe termal	Banjat e Bënjës (me vlera curative për reomatizëm, lëkurën, mushkëri)
Agroturizëm dhe kulinari	Bujtina, ferma familjare, glikoja, raki, mjalti dhe vera vendase
Evente dhe trashëgimi	Festa e glikosë, verës, festivali i sazeve, festa e nonës, dita e verës

VIII.MISIONI ,VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Misioni

Të zhvillojmë turizmin në Përmet si një mekanizëm për rritjen ekonomike, ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, fuqizimin e komunitetit dhe ndërtimin e një destinacioni të qëndrueshëm dhe tërheqës për turistët vendas dhe të huaj.

Vizioni

Përmeti të jetë destinacioni më i njohur për turizmin natyror, termal, kulturor dhe historik në Shqipërinë e jugut, duke ofruar përvoja autentike gjatë gjithë vitit në harmoni me mjedisin dhe traditat vendase.



. Objektivat

1-Rritja e vizitorëve me 50% deri në 2030 (me 10% çdo vit)	Destinacion,Promovim
2-Rritja e netëve të qëndrimit me 35%	Produkti turistik
3-Rritja e numrit të strukturave akomoduese me 30%	Investime,Menaxhim
4-Diversifikimi i produkteve turistike	Produkti dhe Marketing
5-Trajnim i të paktën 150 individëve në turizëm.	Kapacitete
6-Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në turizëm në 30%	Menaxhim,Kapacitete

Shtyllat Strategjike dhe kapacitetet Lokale

1- Investimet

- Restaurimi i rrugëve në destinacionet turistike dhe vendbanimet historike
- Ndërtim parkingje,sinjalistikë turistike
- Infrastrukturë për persona me aftësi të kufizuara në atraksionet kryesore

2- Politika vendore mbështetëse

- Taksa të lehtësuara për struktura të reja agroturistike
- Rregulla për ruajtjen e peizazhit dhe përdorimin tradicional të materialeve ndërtimore në zonat historike.

3- Menaxhimi i destinacionit

- Qendër informimi turistik me staf të trajnuar dhe gjuhë të huaja.
- Manual për menaxhim të fluksit në banjat termale dhe dy parqet kombëtar.

4-Zhvillimi i produkteve turistike

- Intinerare të personalizuar për turizmin kulturor,biologjik, gastronomik.
- Paketat “Weekend në Përmet”,E Vjosa e Egër”,Fshatrat e harresës”
- Turizëm për grupe të vogla,eko-kampi,joga në natyrë.

5-Marketing dhe promovim

- Branding:”Përmeti- Zemra e Natyrës dhe e traditës”
- Uebfaqe shumëgjuhëshe me paketat turistike, feedback,rezervime.
- Prani ne platëforma ndërkombëtare (Booking,AirBnB,TripAdvisor)
- Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare.

6-Formim profesional

- Kurse për guida lokale (me certifikim)
- Trajnime për mikpritje,marketing,trajtim të vizitorëve.
- Kurse për përdorim të platformave digjitale dhe menaxhimin e agroturizmit.



Plani i aktiviteteve (2025-2030)

Viti	Aktiviteti	Shtylla	Partnerë	Rezultati
2025	Branding turistik dhe hartë interaktive	Marketing	AKT, ekspertë	Logo, broshura, website
2025	Restaurim Banjave të Bënjës dhe aksesit rrugëve	Investim	FSHZH, BB, Bashkia	Rritje me 10% vizitorë
2026	Manuali i menaxhimit për destinacionet dhe sinjalistika	Menaxhim	AKZM, ICT, Bashkia	Mbrojtje mjedisore dhe info
2026	Hapja e rrjetit të agro turizmit	Produkt	AZHBR, fermerët	8 ferma aktive
2027	Festivali Ndërkombëtar "Zemra e Vjosës"	Marketing	MEKI, shoqata, Bashkia	Njohje ndërkombëtare
2027-2028	Uebaplikacion dhe QR guides për turistë	Marketing dhe Menaxhim	Kompani IA	Digjitalizim i përvojës turistike
2029-2030	Raport vlerësimi dhe strategji 2030-2035	Menaxhim	Konsulentë	Strategji e përditësuar

Kuadri i veprimit

Për të përhapur vizionin dhe objektivat e planifikuara më parë, Komiteti i Veprimit për Turizmin identifikoi 4 fusha kryesore veprimi me 18 objektiva. Këto fusha janë të varura nga njëra tjetra dhe kanë rëndësi të njëjtë.

Fushat e veprimeve

- 1- Mbrojtja dhe përmirësimi i objekteve në Qendrën Turistike
- 2- Përmirësimi në mënyrë të ndjeshme të infrastrukturës në Qendrën Historike
- 3- Marketingu profesional në tregjet e synuara të brendshme dhe ndërkombëtare



4– Forcimi bashkëpunimit dhe koordinimi mes aktorëve të turizmit dhe ndërtimi i kapaciteteve për të zhvilluar dhe menaxhuar Përmetin si një destinacion turistik

Një përmbledhje e objektivave, tregjeve kryesore të përfshira dhe buxhetete vlerësuar janë të paraqitura në tabelën më poshtë. Më shumë hollësi mbi masat që lidhen me secilën objektivë gjenden në Planin e veprimit.

IX. PLANI I VEPRIMIT PER TURIZMIN

1-Zhvillimi i produkteve dhe përmirësimi i cilësisë

Ekziston nevoja për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe të shërbimeve ekzistuese turistike dhe për të rritur larminë për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, ofertën e produktit, në përputhje me objektivin për të zhvilluar Përmetin si një destinacion turistik me cilësi të lartë që kontribuon në mirëqenien e qytetarëve. Përmirësimi i produkteve dhe shërbimeve ekzistuese fokusohet në zhvillimin e Qendrës Historike dhe të zonave rreth tij (zona e mbrojtur) dhe në ofrimin e produkteve të reja mbështetur në kulturën dhe traditat e Përmetit. Zhvillimi i produkteve dhe i shërbimeve ka si qëllim të rrisë larmishmërinë e produkteve të disponueshme për turistët, si rrjedhim duke tërhequr një treg më të gjerë dhe duke i nxitur vizitorët që të rrinë më gjatë në rajon. Zhvillimi i produkteve dhe i shërbimeve mbështetet në një njohje të kërkesave të turistëve nga tregjet e synuara dhe të nevojave për të krijuar kushtet për një destinacion të qëndrueshëm dhe të lulëzuar.

Aktorët kryesorë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Bashkia e Përmetit, DRKK, Banka Botërore, BE, UNESCO, Donatorët Dypalësh, Drejtoria e Muzeumeve, Drejtoria e Kulturës Kombëtare, Drejtoria Arsimore, Organizatat Jo-Qeveritare, Zyra Rajonale e Turizmit, Bizneset e Sektorit Privat, Zejtarët, Emigrantët, Qytetarët.

RENDI TJA	SYNIMI	OBJEKTIVI	VEPRIMET	ORGANIZATA DREJTUESE	KUR
1	Mbrojtja dhe përmirësimi i objekteve turistike	Mbrojtja dhe përmirësimi i objekteve në Qendrën Turistike	Restaurimi i objekteve të kultit (DRKK)	Ministria e Kulturës dhe e Inovacionit bashkia Përmet	2025-2030
			Rishqyrtimi i rregullorev për ndërhyrje në pacarelat mbi Vjosë	Ministria e Infrastrukturës, Turizmi dhe Mjedisit, bashkia e Përmet	2025-2027
			Kryerja e një fushate të Marrëdhënieve me Publikun për të rritur	Bashkia e Përmet;	2025

			sensibilitetin e komunitetit	Partnerët shqiptarë	
			Përmirësimi i interpretimit në kishat që ndodhen në Qendrat Historike dhe lehtësimi i turistëve për t'i vizituar ato (p.sh. zgjatja e orareve të vizitave deri në 7 ditë në javë)	Bashkia e Përmetit	2025-2026
			Identifikimi i shtëpive të braktisura në Qendrën Historike dhe përgatitja e një plani për rigjallërimin e tyre.	Bashkia e Përmet	2025-2026
			Nxjtja për zhvillimin cilësor të akomodimit në Qendrën Historike mbështetur në kërkesat e parashikuara	Bashkia e Përmet	2025 në vazhdim
2	Mbrojtja dhe përmirësimi i objekteve turistike	Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit në Qendrën Turistike dhe në zonën e mbrojtur	Kryerja e një fushate marredhënie me publikun për të rritur sensibilizimin për nevojën për të mbrojtur mjedisin	Spektori i Mjedisit, Bashkia e Përmetit	Në vazhdim
			Zhvillimi i aktiviteteve edukative në zonat natyrore për të rritur sensibilizimin mjedisor të qytetarëve të Përmet		Në vazhdim
			Zhvillimi i trajnimeve për vullnetarizëm	Bashkia Përmet; PNUD-i	2025
			Organizimi i 'ditëve të vullnetarëve' për të pastruar mjedisin në qytet	Bashkia e Përmet	Pesë herë në vit
